



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 konform Raportit të Komisionit për hartimin e librit të proceseve për menaxhimin e shpenzimeve publike i datës 28.07.2020, Kryetari i Komunës merr :

### VENDIM

I. **APROVOHET**, dokumenti - **Libri i proceseve për menaxhimin e shpenzimeve publike** i hartuar nga Komisioni për hartimin e librit të proceseve për menaxhimin e shpenzimeve publike.

II. Vendimi hyn në fuqi menjëherë

Vendimi i dërgohet:  
Drejtoratit për Buxhet dhe Financa

1Nr. 400-32442  
Lipjan, më 30.07.2020

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, si dhe Rregullores MF Nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontollin, Kryetari i Komunës merr :

## ANEKS VENDIM

I. **APROVOHET, plotësim/ndryshimi** i kapitullit të III-të “Procesi i kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta”, si pjesë përbërëse e Doracakut “**Libri i Proceseve për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike**”, i cili përmban komponentët/proceset e: buxhetit komunal, menaxhimit të pagave, kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta, shpenzimeve për mallra shërbime, shpenzimeve për avance dhe para të imët, shpenzimeve për udhëtime zyrtare, shpenzimeve për komunalitetë, shpenzimeve për subvencione dhe transfere, shpenzimeve për investime kapitale, menaxhimit të projekteve, prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. **Ky proces i është nënshtruar plotësim/ndryshimit si rezultat i ndryshimeve në kornizën ligjore, ku aktualisht procesi në fjalë rregullohet sipas: Ligjit për Prokurimin Publik 04/L-042, Ligjit për zyrtarët publik 06-L-114, Rregullës për prokurim të Shërbimeve të Veçanta (konsulentët/kontraktorët individual), si dhe Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik.**

II. Pjesë përbërëse e këtij aneks vendimi është versioni i plotësuar/ndryshuar i kapitullit III “Procesi i kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta” të Doracakut “**Libri i Proceseve për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike**”.

III. Për zbatimin e këtij aneks vendimi do të kujdesen: Drejtoritë komunale, Zyra e Prokurimit dhe Zyrtarët publik kompetent të Komunës.

IV. Aneks vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Me këtë Vendim të njoftohen:**

- Drejtorët e drejtorive të Komunës
- Zyra e prokurimit
- Zyrtarët kompetent të Komunës
- Arkivi i Komunës

INr. 030 - 35722  
Lipjan, më 01.07.21

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

**LIBRI I PROCESIVE  
PËR  
MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE**

## TABELA E PËRMBAJTJES









<b>SHKURTESAT</b>	<b>4</b>
<b>LEGJENDA</b>	<b>5</b>
<b>HYRJE</b>	<b>6</b>
<b>I. Procesi i Buxhetit Komunë</b>	<b>8</b>
1. Procesi i Buxhetit Komunë: Të dhënat e Përgjithshme	9
2. Procesi i Buxhetit Komunë: Procesi në Detaj	11
3. Procesi i Buxhetit Komunë: Lista e Rreziqeve	26
4. Procesi i Buxhetit Komunë: Diagrami i Procesit	34
<b>II. Procesi i Menaxhimit të Pagave</b>	<b>39</b>
1. Procesi i Menaxhimit të Pagave: Të Dhënat e Përgjithshme	40
2. Procesi i Menaxhimit të Pagave: Procesi në Detaj	41
3. Procesi i Menaxhimit të Pagave: Lista e Rreziqeve	55
4. Procesi i Menaxhimit të Pagave: Diagrami i Procesit	63
<b>III. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta</b>	<b>67</b>
1. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta: Të Dhënat e Përgjithshme	<b>Error!</b>
<b>Bookmark not defined.</b>	
2. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta: Procesi në Detaj	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta: Lista e Rreziqeve	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4. Procesi i Kontratave Për Shërbime me Marrëveshje të Veçanta: Diagrami i Procesit	68
<b>IV. Procesi i shpenzimeve - Mallra dhe Shërbime</b>	<b>96</b>
1. Procesi i Shpenzimeve - Mallra dhe Shërbime: Të dhënat e Përgjithshme	97
2. Procesi i Shpenzimeve - Mallra dhe Shërbime: Procesi Në Detaj	100
3. Procesi i Shpenzimeve - Mallra dhe Shërbime: Lista e Rreziqeve	123
4. Procesi i Shpenzimeve: Mallra dhe Shërbime: Diagrami i Procesit	131
<b>V. Procesi i Shpenzimeve - Avance dhe Paraja e Imët</b>	<b>136</b>
1. Procesi i Shpenzimeve – Avancet dhe Paraja e Imët: Të Dhënat e Përgjithshme	137
2. Procesi i Shpenzimeve – Avancet dhe Paraja e Imët: Procesi në Detaj	138
3. Procesi i Shpenzimeve – Avancet dhe Paraja e Imët: Lista e Rreziqeve	147
4. Procesi i Shpenzimeve – Avancet dhe Paraja e Imët: Diagrami i Procesit	153
<b>VI. Procesi i Shpenzimeve - Udhëtimet Zyrtare</b>	<b>155</b>
1. Procesi i Shpenzimeve – Udhëtimet Zyrtare: Të Dhënat e Përgjithshme	156
2. Procesi i Shpenzimeve – Udhëtimet Zyrtare: Procesi në Detaj	158
3. Procesi i Shpenzimeve – Udhëtimet Zyrtare: Lista e Rreziqeve	165
4. Procesi i Shpenzimeve – Udhëtimet Zyrtare: Diagrami i Procesit	171
<b>VII. Procesi i shpenzimeve - Komunalitë</b>	<b>173</b>
1. Procesi i Shpenzimeve - Komunalitë: Të Dhënat e Përgjithshme	174
2. Procesi i Shpenzimeve - Komunalitë: Procesi Në Detaj	176
3. Procesi i Shpenzimeve - Komunalitë: Lista e Rreziqeve	185
4. Procesi i Shpenzimeve - Komunalitë: Diagrami i Procesit	191
<b>VIII. Procesi i Shpenzimeve - Subvencione dhe Transfere</b>	<b>193</b>
1. Procesi i Shpenzimeve – Subvencione dhe Transfere: Të Dhënat e Përgjithshme	194
2. Procesi i Shpenzimeve – Subvencione dhe Transfere: Procesi në Detaj	196
3. Procesi i Shpenzimeve – Subvencione dhe Transfere: Lista e Rreziqeve	211
4. Procesi i Shpenzimeve – Subvencione dhe Transfere: Diagrami i Procesit	219
<b>IX. Procesi i shpenzimeve - Investimet Kapitale</b>	<b>222</b>
1. Procesi i Shpenzimeve - Investimet Kapitale: Të Dhënat e Përgjithshme	223
2. Procesi i Shpenzimeve - Investimet Kapitale: Procesi në Detaj	226
3. Procesi i Shpenzimeve - Investimet Kapitale: Lista e Rreziqeve	250
4. Nën Procesi i menaxhimit të pasurive mbi 1,000€ dhe nën 1,000€ : Lista e Rreziqeve	263
5. Procesi i Shpenzimeve - Investimet Kapitale: Diagrami i Procesit	275
<b>X. Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale</b>	<b>280</b>
1. Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale: Të Dhënat e Përgjithshme	281
2. Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale: Procesi në Detaj	284

3.	Procesi i Integruar i Investimeve Kapitale: Diagrami i Procesit	325
<b>XI.</b>	<b>Procesi i Menaxhimit të Projekteve</b>	<b>327</b>
1.	Procesi i Menaxhimit të Projekteve: Të Dhënat e Përgjithshme	328
2.	Procesi i Menaxhimit të Projekteve: Procesi në Detaj	330
3.	Procesi i Menaxhimit të Projekteve: Lista e Rreziqeve	340
4.	Procesi i Menaxhimit të Projekteve: Diagrami i Procesit	348
<b>XII.</b>	<b>Procesi i Prokurimit</b>	<b>350</b>
1.	Procesi i Prokurimit: Të Dhënat e Përgjithshme	351
2.	Procesi i Prokurimit: Procesi në Detaj	353
3.	Procesi i Prokurimit: Lista e Rreziqeve	370
4.	Procesi i Prokurimit: Diagram i Procesit	381
<b>XIII.</b>	<b>Procesi i Menaxhimit të Kontratave</b>	<b>385</b>
1.	Procesi i Menaxhimit të Kontratave: Të Dhënat e Përgjithshme	386
2.	Procesi i Menaxhimit të Kontratave: Procesi në Detaj	387
3.	Procesi i Menaxhimit të Kontratave: Lista e Rreziqeve	397
4.	Procesi i Menaxhimit të Kontratave: Diagrami i Procesit	406

## SHKURTESAT

<b>AQP</b>	Agjencia Qendrore e Prokurimit
<b>ATK</b>	Administrata Tatimore i Kosovës
<b>BDK</b>	Bordi i Drejtorëve në Komunë
<b>BNJ</b>	Burimet Njerëzore
<b>BQK</b>	Banka Qendrore e Kosovës
<b>DBF</b>	Drejtori për Buxhet dhe Financa
<b>DNPDP</b>	Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve
<b>DPT</b>	Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit
<b>FDHLP</b>	Formulari i të Dhënave të Listës së Pagave
<b>KAB</b>	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
<b>KK</b>	Kuvendi Komunal
<b>KMC</b>	Komision për Monitorimin e Cilësisë
<b>KPF</b>	Komiteti për Politike dhe Financa
<b>KPK</b>	Komiteti për Komunitete
<b>KPM</b>	Komisioni i Pranimit të Materialit
<b>KPPTP</b>	Komisioni për Pranim të Përkohshëm Teknik të Punimeve
<b>LLVTh</b>	Llogaria e Vetme e Thesarit
<b>LMFPP</b>	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
<b>MAP</b>	Ministria e Administratës Publike
<b>MEK</b>	Menaxheri i Ekzekutimit të Kontratës
<b>MEP</b>	Menaxheri i Ekzekutimit të Projektit
<b>MEU</b>	Mbikëqyrësi i Ekzekutimit të Urdhërësës
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>NJQH</b>	Njësia Qendrore Harmonizuese e Kosovës
<b>OE</b>	Operatori Ekonomik
<b>OJQ</b>	Organizatë Jo Qeveritare
<b>OSHP</b>	Organi Shqyrtues i Prokurimit
<b>PIP</b>	Projekti i Investimeve Publike
<b>QKMF</b>	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
<b>QSHQ</b>	Qendra për Shërbime me Qytetarë
<b>SIMBNJ</b>	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
<b>SIMFK</b>	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar në Kosovë
<b>SIP</b>	Sistemi Informativ i Pagave
<b>SMVP</b>	Sistemi Informativ i Vijueshmërisë në Punë
<b>SZHMB</b>	Sistemi për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Buxhetit
<b>UOP</b>	Urdhër Obligimin për Pagesë
<b>ZKF</b>	Zyrtari Kryesor Financiar
<b>ZP</b>	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

**LEGJENDA**



## **HYRJE**

Ky dokument përbën një përmbledhje të proceseve kryesore të cilat kanë implikime në hallkat e kontrollit dhe ekzekutimit financiar në komuna në Kosovë. Proceset e poshtëshënuara mbështeten në Ligjet e Republikës së Kosovës, Udhëzimet Administrative, Rregulloret dhe procedurat e institucioneve qendrore dhe lokale. Libri i Proceseve synon të sqarojë dhe konsolidojë procedurat që duhet ndjekur për të siguruar kontroll të rregullsisë dhe cilësisë në procesin e buxhetimi dhe ekzekutimit të tij.

## **Qëllimi**

Libri i Proceseve përbën një përmbledhje të proceseve të cilat qoftë në tërësi apo pjesërisht ndikojnë në performancën, mbikëqyrjen dhe rregullsinë financiare të Komunave. Ky libër vjen si rezultat i iniciativës të Njësisë Qendrore Harmonizuese të Ministrisë së Financave për të inkurajuar draftimin e proceseve në secilën organizatë buxhetore me qëllim të thjeshtëzimit të punës.

## **Përdorimi**

Libri i Proceseve është një dokument i “gjallë” i cili duhet të rishikohet së paku në baza të rregullta për të reflektuar ndryshimet e mundshme në kornizën ligjore apo rregullative dhe përmirësimet në praktikën e mira kombëtare dhe ndërkombëtare në proceset e përfshira në këtë libër. Ndryshimet në Libër të Proceseve duhet të bëhen rregullisht, dhe këto ndryshime si dhe versioni i përditësuar i dokumentit duhet t’u komunikohet të gjithë palëve të interesit.

Ky dokument gjithashtu ndihmon në caktimin e qartë të vijave të përgjegjësive të të gjithë palëve të përfshira në proces si dhe hallkave që duhen ndjekur për të siguruar integritetin e funksioneve të institucioneve përkatëse. Nga ana tjetër, një përmbledhje e detajuar e proceseve gjithashtu ndihmon në përgatitjen e stafit ekzistues dhe atij të ri në mbarëvajtjen e detyrave të pozitive të tyre.


## **Struktura e librit**

Ky dokument e shfleton secilin proces në tre mënyra. Për secilin proces, përdoruesit mund të gjejnë një përshkrim të përgjithshëm me informatat kryesore rreth pronarit të procesit (apo personit kryesor përgjegjës), ligjeve dhe rregulloreve që ndikojnë procesin, dokumenteve që duhen prodhuar, mjeteve informative të përfshira si dhe detaje të tjera. Pas përshkrimit, secili proces gjithashtu përmban hallkat e detajuara të procesit të cilat shpjegojnë veprimet, informatat, dokumentet, afatet dhe personat përgjegjës për secilën hallkë. Në fund, secili proces ka diagramin e vet i cili synon të lehtësojë kuptimin e procesit në tërësi si dhe ndjekjen e lehtë të procesit gjatë implementimit dhe mbikëqyrjes.

Në fund, ky libër përmban hallka të proceseve të cilat në mungesë të rregullativës specifike ligjore i janë përmbajtur praktikave të mira në mbarëvajtjen e proceseve. Këto hallka janë zhvilluar si rezultat i eksperiencës dhe praktikave të implementuara në komunën që ka zhvilluar këtë Libër të Proceseve.



Diagrami i Përgjithshëm i Integruar i Procesit të Planifikimit dhe Shpenzimit



## **I. PROCESI I BUXHETIT KOMUNË**

## 1. PROCESI I BUXHETIT KOMUNË: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

<b>Titulli i procesit:</b>	Procesi i Buxhetit Komunë
<b>Organizata Buxhetore:</b>	Komuna Lipjan
<b>Data e rishikimit:</b>	<TBD>
<b>Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:</b>	<p>Procesi ka për qëllim përshkrimin e procedurave të përgatitjes së buxhetit Komunë si dhe ndërlidhjes së procedurave Komunë të përgatitjes së buxhetit me përgatitjen e buxhetit kombëtar.</p> <p>Procesi evidenton hallkat vendimmarrëse brenda Komunës sa i përket proceseve të planifikimit, draftimit, dëgjimeve publike dhe rishikimit pas qarkoreve qendrore buxhetore të buxhetit. Procesi gjithashtu evidenton proceset e komunikimit dhe bashkërendimit me Ministrinë e Financave për buxhetin e përgjithshëm kombëtar.</p>
<b>Përgjegjësi për rishikim të procesit:</b>	Njësia Qendrore Harmonizuese – Ministria e Financave
<b>Versioni:</b>	V. 01/2018
<b>Korniza ligjore:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.</li> <li>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal.</li> </ol>
<b>Pronari i Procesit:</b>	1. Kryetari i Komunës
<b>Palët e përfshira në proces:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ministria e Financave</li> <li>2. Analisti/ja për Buxhet Komunë në Ministrinë e Financave</li> <li>3. Kryetari i Komunës</li> <li>4. Drejtori për Buxhet dhe Financa / Zyrtari Kryesor Financiar Komunë</li> <li>5. Drejtorët e Drejtorive Komunëe</li> <li>6. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF)</li> <li>7. Kuvendi Komunë dhe Kryesuesi</li> </ol>
<b>Sistemet e TI të përfshira në proces:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB)</li> <li>2. E-Mail</li> <li>3. Ueb faqet e Ministrisë së Financave dhe Komunës</li> <li>4. Programi i Investimeve Publike (PIP)</li> </ol>
<b>Dokumentet e përfshira në proces:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Qarkorja e Parë Buxhetore</li> <li>2. Qarkorja e Dytë Buxhetore</li> <li>3. Qarkorja e Brendshme Komunëe</li> <li>4. Korniza Afatmesme e Buxhetit (KAB)</li> <li>5. Projekt Buxheti</li> <li>6. Lista e propozimeve dhe ideve nga dëgjimet publike</li> <li>7. Vendimi i Kuvendit Komunë për aprovimin e Draft Buxhetit</li> <li>8. Shkresa përcjellëse e Kryetarit të Komunës për dërgimin e buxhetit të aprovuar të Ministrisë e Financave</li> <li>9. Tabelat e buxhetit (4.1, 4.2 dhe 4.3)</li> </ol>

	10. Formularët e Shpenzimit të Departamenteve (PCF1, PCF2, PCF3, PCF4)
<b>Ndërlidhja:</b>	Nuk ka
<b>Numri i hapave:</b>	26

## 2. PROCESI I BUXHETIT KOMUNË: PROCESI NË DETAJ

Procesi i përgatitjes së buxhetit Komunë						
Hapat	Aktiviteti	Aktivitetet e Kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet	Korniza ligjore
1.	Pranimi i qarkores së parë nga Ministria e Financave	<p>1.1 Qarkorja e Ministrisë së Financave pranohet nga zyra e Kryetarit të Komunës përmes postës elektronike (e-mail), Drejtori për Buxhet dhe Financa (DBF)/Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF). Qarkorja gjithashtu publikohet në ueb faqen zyrtare të MF.</p> <p>1.2 DBF/ZKF përcjell qarkoren tek drejtorët e të gjitha drejtorive, udhëheqëit e programeve dhe tek të gjithë palët me interes përmes e-mailit dhe/ose në kopje fizike.</p>	<p>1. Zyra e Kryetarit</p> <p>2. DBF/ZKF</p>	Deri me 15 Maj	1. Qarkorja në format Word	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë <a href="#">(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</a>.</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal <a href="#">(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</a>.</p>

2	Hartimi i qarkores së brendshme Komunëe	<p>2.1 Kryetari i Komunës e dërgon qarkoren tek Drejtori për Buxhet dhe Financa (DBF) / Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF).</p> <div data-bbox="613 328 1075 587" style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 10px; margin: 10px 0;"> <p style="text-align: center;">KUTIA 1</p> <p>Qarkorja e brendshme përcakton, qëllimet, objektivat, afatet dhe kërkesat nga drejtorët e drejtorive për shpenzimet për 3 vitet e ardhshme</p> </div> <p>2.2 DBF/ZKF siguron zhvillimin e qarkores së brendshme të komunës (në nivel të programeve/nënprogrameve dhe kategorive të shpenzimeve).</p> <p>2.2.1 Qarkoren e brendshme e përgatitë (vendosja e të dhënave në tabela të buxhetit) DBF/ZKF. Kjo bëhet bazuar në informatat financiare nga vitet paraprake.</p>	<p>1. Kryetari i Komunës</p> <p>2. Drejtorët e Drejtorisë Përkatëse</p>	15-22 Maj	1. Qarkorja e Brendshme Komunëe në format Word	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p>
3	Shpërndarja/dorë zimi i qarkores së brendshme Komunëe	<p>3.1 DBF/ZKF e shpërndan qarkoren e brendshme buxhetore tek drejtorët e të gjitha drejtorive dhe udhëheqësit e programeve.</p> <p>3.2 Drejtorët e drejtorive e shpërndajnë qarkoren e brendshme te:</p>	<p>1. DBF/ZKF</p> <p>2. Drejtorët e Drejtorive Komunëe dhe udhëheqësit e</p>	22 Maj	1. Qarkorja e Brendshme Komunëe	NA

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëheqësit e njësive në kuadër të drejtorive të tyre;</li> <li>• Drejtorët e shkollave dhe çerdheve; dhe</li> <li>• Udhëheqësit e institucioneve shëndetësore.</li> </ul>	njësive/program eve			
4	Paraqitja e kërkesave buxhetore nga drejtoritë dhe programet tek DBF/ZFK për përgatitje të KAB	<p>4.1 Pas pranimit të qarkores së brendshme, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e programeve fillojnë me përgatitjen e kërkesave buxhetore.</p> <p>4.2 Drejtorët e drejtorive diskutojnë kërkesat buxhetore me stafin e tyre.</p> <p>4.3 Drejtorët e drejtorive dërgojnë propozimet buxhetore tek DBF/ZKF.</p>	<p>1. Drejtorët e drejtorive dhe stafi i tyre</p> <p>2. Udhëheqësit e njësive</p> <p>3. DBF/ZKF</p>	5 Qershor	1. Formulari i nënshkruar nga drejtorët e drejtorive	NA
5	Dëgjimet e hershme buxhetore  [OPSIONALE]	5.1 Kryesuesi i Komitetit për Politike dhe Financa, në bashkëpunim me DBF/ZKF, drejtorët e drejtorive mbajnë dëgjime të hershme publike para hartimit të Kornizës Afatmesme Komunëe të Buxhetit.	<p>1. Kryesuesi Kuvendit</p> <p>2. DBF/ZKF</p>	Fund i Majit	<p>1. Njoftimi për dëgjime buxhetore</p> <p>2. Përmbledhja e dëgjimeve të hershme buxhetore.</p>	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (<a href="#">Gazeta Zyrtare e</a></p>

						<a href="#">Republikës së Kosovës</a> ).
6	Hartimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB)	6.1 Bazuar në strategjinë zhvillimore Komunëe, propozimet buxhetore të drejtorive dhe programeve si dhe inputet nga dëgjimet publike (brenda kufijve buxhetor), Kryetari i Komunës në bashkëpunim me DBF/ZKF, dhe drejtorët e drejtorive hartojnë draft Kornizën Afatmesme të Buxhetit (KAB).	1. Kryetari i Komunës 2. Drejtorët e drejtorive 3. DBF/ZKF	10 Qershor	1. Draft KAB	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).  2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).
7	Prezantimi i draft KAB në Komitetin për Politikë dhe Financa	7.1 Kryetari i komunës e aprovon draft KAB-it. 7.2 Pas aprovimit, Kryetari së bashku me DBF/ZKF prezanton draft KAB në Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF).	1. Kryetari i Komunës 2. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF)  3. Komiteti për Komunitete (KPK)	10-25 Qershor	1. Draft KAB	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).  2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal



						<a href="#">(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</a> .
8	Inputet nga komitetet	8.1 Propozim ndryshimet eventuale të komiteteve plotësohen nga DBF/ZKF në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive përkatëse.	1. Kryetari i Komunës  2. DBF/ZKF  3. Drejtorët e drejtorive	25-30 Qershor	1. Draft KAB	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).  2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).
9	KAB në Kuvend Komunë	9.1 Draft KAB dërgohet në Kuvend Komunë për shqyrtim dhe aprovim.  9.2 KAB aprovohet nga Kuvendi Komunë dhe vendimi për aprovim të KAB-it nënshkruhet nga Kryesuesi i Kuvendit Komunë.  9.3 Nëse Kuvendi Komunë nuk aprovon dhe dorëzon buxhetin tek Ministria e Financave brenda afatit ligjor, atëherë, Ministri i Financave është i	1. Kryetari i Komunës  2. Kuvendi Komunë  3. Kryesuesi i Kuvendit Komunë	Deri më 30 Qershor	1. Vendimi i për aprovim KAB	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).  2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e

		<p>autorizuar që të përgatis propozim buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore për komunën duke u bazuar por duke mos e tejkalluar buxhetin dhe ndarjet buxhetore të vitit aktual fiskal.</p> <p>9.4 Nëse deri më 1 Mars, Kuvendi Komunë përsëri dështon që të miratoj dhe dorëzoj në MF propozim buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore, atëherë asnjë shpenzim nuk duhet të bëhet nga ose në emër të komunës derisa kuvendi nuk e aprovon dhe dorëzon buxhetin në Ministri të Financave.</p>				<p>Pushtetit Lokal (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p>
10	Dorëzimi i KAB në MF	10.1 Kryetari i Komunës e dërgon KAB (të aprovuar nga Kuvendi Komunë) në MF.	1. DBF/ZKF	30 Qershor	1. KAB-i aprovuar	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (<a href="#">Gazeta Zyrtare e</a></p>

						<a href="#">Republikës së Kosovës</a> ).
11	Pranimi i qarkores së dytë nga Ministria e Financave	<p>11.1 Dokumenti i Ministrisë së Financave pranohet në formë elektronike (e-mail) nga Kryetari i Komunës. Qarkorja gjithashtu publikohet në ueb site të MF.</p> <div style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 10px; text-align: center;"> <p>KUTIA 2</p> <p>Përderisa Qarkorja e parë përcakton kufijtë buxhetor, qarkorja e dytë specifikon se ku do të shpenzohet buxheti. Ministria e Financave mund të lëshojë më shumë se 1 qarkore</p> </div>	1. Kryetari i komunës	Nuk ka	Qarkorja e dytë buxhetore në Word	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p>
12	Hartimi i qarkores së dytë të brendshme të Komunës dhe shpërndarja e saj tek drejtorët e drejtorive	<p>12.1 Hartohet qarkorja e dytë e brendshme e komunës nga DBF/ZKF (përfshihen inputet nga diskutimet e brendshme nga drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e programeve).</p> <p>12.2 DBF/ZKF dërgojnë qarkoren e dytë të brendshme tek drejtorët dhe udhëheqësit e njësive për plotësim. Qarkorja përcakton kufijtë buxhetor për kategori të shpenzimeve.</p>	2. DBF/ZKF	Fundi i Korrikut	1. Qarkorja e Dytë Buxhetore	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal</p>

						<a href="#">(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</a> .
13	Dëgjimet publike	13.1 Mbahen dëgjime publike me qytetarë me qëllim të diskutimit të Projektbuxhetit.	1. Kryesuesi i Kuvendit  2. DBF/ZKF	Muaji gusht	1. Projektbuxheti	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).  2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).
14	Përgatitja e projekt buxhetit dhe kërkesave për ndarje buxhetore në nivel të drejtorive	14.1 Pas pranimit dhe shpërndarjes së qarkores së dytë të brendshme, drejtorët e drejtorive organizojnë diskutime brenda drejtorive për të diskutuar kërkesat buxhetore.  14.2 Drejtorët e drejtorive i dërgojnë kërkesat buxhetore tek DBF/ZKF.	1. DBF/ZKF  2. Drejtorët e drejtorive		Propozimet buxhetore (PCF1,2,3 dhe 4)	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).  2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e

						Pushtetit Lokal ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).
15	Kontrollimi i propozimeve buxhetore dhe kërkesave për ndarje buxhetore sipas qarkores së dytë	15.1 Kërkesat e drejtorive për ndarje buxhetore përkatëse diskutohen dhe dakordohen me Kryetarin e Komunës dhe DBF/ZKF.	1. Kryetari i Komunës  2. DBF/ZKF  3. Shefi i planifikimit të buxhetit		NA	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).  2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).
16	Dorëzimi i projekt buxhetit dhe kërkesave për ndarje buxhetore në Kuvend Komunë	16.1 Projekt buxheti diskutohet nga Kryetari i Komunës dhe bordi i drejtorëve dhe i dërgohet sekretarisë së Kuvendit Komunë.	1. Drejtorët e drejtorive  2. Kryesuesi i Kuvendit Komunë	Para 1 Shtatorit	Projekt buxheti në kopje	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).

						2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).
17	Futja e të dhënave preliminare buxhetore në Sistemin për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Buxhetit (SZHMB) dhe në Programin e Investimeve Publike (PIP)	17.1 Të dhënat buxhetore për të gjitha kategoritë e shpenzimeve futen në SZHMB dhe PIP nga zyrtarët e autorizuar.  17.2 Të gjitha këto të dhëna kontrollohen nga DBF/ZKF.	1. Zyrtarët e autorizuar  2. DBF/ZKF	Deri më 30 Shtator	1. Formularët e buxhetit të departamenteve nga SZHMB (PCF1,2,3 dhe 4)  2. Tabelat e buxhetit (4.1, 4.2, 4.3)	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).  2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).
18	Dëgjimet publike shtesë	18.1 Mbahen dëgjime publike me qytetarë me qëllim të diskutimit të Projektbuxhetit me qytetarë.	1. DBF/ZKF  2. Kryesuesi i Kuvendit	1-12 Shtator	1. Përmbledhja e inputit nga dëgjimet publike	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).

						2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).
19	Shqyrtimi i kërkesave në KPF	19.1 Propozimet/idetë eventuale nga dëgjimet publike mund të dërgohen në KPF për shqyrtim.	1. KPF	1-12 Shtator	1. Propozimet/idetë nga dëgjimet publike	
20	Prezantimi në Kuvendin Komunë	20.1 Pas shqyrtimit të buxhetit në KPF, projekt buxheti prezantohet dhe diskutohet në Kuvendin Komunë.	1. Kryetari i Komunës	Deri 30 Shtator	1. Projekt buxheti	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).  2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).

21	Korrigjime në dokumentin e buxhetit duke u bazuar në inputet e dëgjimeve/komiteve/kuvendit	21.1 Nëse ka kërkesa për ndryshime (nga dëgjimet publike/komitetet/Kuvendi Komunë), projekt buxheti kthehet tek Kryetari i Komunës dhe DBF/ZKF për korrigjimet plotësuese dhe vendosjen e tyre në SZHMB dhe PIP.	1. Kryetari i Komunës	12-20 Shtator	1. Draft buxheti i korrigjuar	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p>
22	Aprovimi i buxhetit nga Kuvendi Komunë	22.1 Buxheti aprovohet nga Kuvendi Komunë.	1. Kuvendi Komunë	Deri me 30 Shtator	<p>1. Buxheti i aprovuar</p> <p>2. Vendim i Kuvendit Komunë</p>	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (<a href="#">Gazeta Zyrtare e</a></p>



						<a href="#">Republikës së Kosovës</a> ).
23	Azhurnimi i buxhetit nëse ka pasur ndryshime gjatë aprovimit në Kuvend Komunë	23.1 Nëse buxheti i aprovuar në kuvend ndryshon nga projekt buxheti, ndryshimet vendosen në SZHMB dhe PIP nga zyrtarët e autorizuar.	1. Zyrtarët e autorizuar	Deri 30 Shtator	1. Buxheti i Aprovuar	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).  2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).
24	Njoftimi i analistëve në MF dhe kontrolli final	24.1 Drejtori për Buxhet dhe Financa/ZKF gjatë gjithë kohës dhe sipas nevojës konsultohet me analistët e buxhetit në Ministri të Financave për për asistencë gjatë hartimit të buxhetit.  24.2 Nëse ka nevojë analisti i MF-së jep udhëzimet e nevojshme për komunën.	1. DBF/ZKF  2. Analistët e buxhetit në MF	Deri 30 Shtator	NA	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ( <a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a> ).  2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal

						<a href="#">(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</a> .
25	Dorëzimi i Buxhetit në Ministrinë e Financave	<p>25.1 Buxheti i komunës (i aprovuar në kuvend dhe nënshkruar prej kryesuesit të kuvendit) dërgohet në MF.</p> <p>25.1.1 Bashkëngjitet shkresa përcjellëse nga Kryetari i Komunës për MF.</p> <p>25.1.2 Dorëzohen tabelat buxhetore të zhvilluara nga SMZHB dhe PIP.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tabela 4.1: Plani i ndarjes buxhetore të shpenzimeve.</li> <li>• Tabela 4.2: Financimi i projekteve kapitale.</li> <li>• Tabela 4.3: Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit Komunë nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake.</li> <li>• Vendimi i Kuvendit Komunë mbi aprovimin e buxhetit</li> <li>• Formulari i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator</li> </ul>	1. Kryetari i Komunës	30 shtator	<p>1. Dokumenti i buxhetit në kopje fizike dhe elektronike</p> <p>2. Shkresa përcjellëse</p> <p>3. Tabela 4.1</p> <p>4. Tabela 4.2</p> <p>5. Tabela 4.3</p> <p>6. Vendimi i Kuvendit Komunë mbi aprovimin e buxhetit</p>	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë <a href="#">(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</a>.</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal <a href="#">(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</a>.</p>

					7. Formulari i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjnor	
26	Kontrolli final dhe aprovimi i buxhetit nga analistët e MF	<p>26.1 Analisti i buxhetit në MF bën kontrollin e fundit nëse buxheti është brenda kufijve të caktuar me qarkoren e dytë buxhetore në kategoritë ekonomike.</p> <p>26.2 Nëse ka ndonjë mospërputhje, buxheti kthehet mbrapa për korrigjim tek komuna</p> <p>26.3 Finalizimi i buxhetit Komunë dhe përfshirja e tij në projektbuxhetin e përgjithshëm shtetëror dhe aprovimi në Qeverinë e Republikës së Kosovës.</p>	1. Analistët e buxhetit	30 Shtator		<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p> <p>2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (<a href="#">Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</a>).</p>
<b>Fundi i procesit të përgatitjes së buxhetit Komunë</b>						

### 3. PROCESI I BUXHETIT KOMUNË: LISTA E RREZIQEVE

3.1 Mbivlerësimi/nënvlerësimi i kërkesave buxhetore nga drejtoritë dhe programet buxhetore

3.2 Buxhet jo në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës

3.3 Buxheti jo gjithëpërfshirës i cili nuk adreson kërkesat dhe nevojat e qytetarëve

3.4 Mos aprovimi i buxhetit nga Kuvendi Komunë

	Numri i Referencës	<b>3.1</b>
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Financiar
	Nën procesi	Procesi i buxhetit Komunë
	Objektivi	<i>Buxhet gjithëpërfshirës, transparent në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës dhe qeverisë, në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.</i>
	Ngjarja e rrezikut	<b>Mbivlerësimi/nënvlerësimi i kërkesave buxhetore nga drejtoritë dhe programet buxhetore</b>
	Shkaku i Rrezikut	Nevoja të reja dhe rrethana të ndryshuara Mos vlerësimi i saktë i kostove të kërkesave buxhetore Mungesa e kapaciteteve në përgatitjen e buxhetit
	Ndikimi/Pasoja	Dështimi për të siguruar mjete buxhetore për të plotësuar kërkesat e departamenteve Drejtoritë dështojnë të përmbushin objektivat e tyre Buxhet i pa shpenzuar

<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

		Mos realizimi i kërkesave dhe nevojave Anulimi i procedurave të blerjeve dhe nevoja për përsëritje të tyre Dështimi për të ofruar shërbime ndaj qytetarëve
	Masat ekzistuese të kontrollit	Qarkoret buxhetore të Ministrisë së Financave Qarkoret e brendshme buxhetore të komunës Kordinimi i procesit buxhetor nga Zyrtari Kryesor Financiar
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	4
	Pasoja (1-5)	2
	Rezultati	8
	Prioriteti i rrezikut	Mesëm
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Jo të përshtatshme
	Veprimi	Zvogëlimi
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Trajnimi i stafit për rritjen e kapaciteteve planifikuese Kujdes i shtuar gjatë procesit të planifikimit Vlerësimi i kostove të kërkesave buxhetore bazuar me çmimet e tregut
	Forma e masave	Plan i trajnimit, hulumtim i tregut
	Burimet që kërkohen	Financiare, njerëzore

<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

	Pronari i rrezikut	Drejtori për Buxhet dhe Financa (DBF) /Zyrtar i Kryesor Financiar (ZKF)
	Data e përfundimit	TM1 2019
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	MAP, MF, MAPL
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët

	Numri i Referencës	3.2
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Strategjik, Financiar
	Nën procesi	Procesi buxhetor Komunë
	Objektivi	<i>Buxhet gjithëpërfshirës, transparent në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës dhe qeverisë, në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.</i>
	Ngjarja e rrezikut	<b>Buxhet jo në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës</b>
	Shkaku i Rrezikut	Kuptimi i dobët i objektivave strategjike Komunë nga stafi i përfshirë në proces të buxhetit Paraqitja e objektivave të reja dhe interesimi i menaxhmentit për financimin e projekteve ad-hoc jashtë fushave
	Ndikimi/Pasoja	Dështimi për të realizuar objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës Shpenzime jo efektive dhe mungesa e buxhetit për financimin e nevojave prioritare

<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

		Dështimi për të përmbushur pritjet e qytetarëve
	Masat ekzistuese të kontrollit	Dokumentet dhe planet strategjike të komunës Korniza Afatmesme e Buxhetit Procesi i dëgjimeve buxhetore Monitorimi i procesit të buxhetit
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	3
	Pasoja (1-5)	3
	Rezultati	9
	Prioriteti i rrezikut	Mesëm
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Të pa mjaftueshme
	Veprimi	Trajtim dhe zvogëlim
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Përdorimi i objektivave dhe prioritetëve strategjike të komunës të vendosura në dokumente strategjike dhe Kornizën Afatmesme të Buxhetit si bazë për buxhetim Përgatitja e KAB në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës si dhe përdorimi i KAB si dokument bazë gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor
	Forma e masave	Plan vjetor për përgatitje të buxhetit
	Burimet që kërkohen	Angazhim i stafit Komunë
	Pronari i rrezikut	DBF/ZKF

<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

	Data e përfundimit	TM1 2019
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	MF
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët

	Numri i Referencës	3.3
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Strategjik, Operativ
	Nën procesi	Procesi i buxhetit Komunë
	Objektivi	<i>Buxhet gjithëpërfshirës, transparent në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës dhe qeverisë, në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.</i>
	Ngjarja e rrezikut	<b>Buxheti jo gjithëpërfshirës i cili nuk adreson kërkesat dhe nevojat e qytetarëve</b>
	Shkaku i Rrezikut	Mos përfshirja e qytetarëve në procesin e përgatitjes së buxhetit Dështimi për të organizuar dëgjime publike apo pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në dëgjime buxhetore Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve nuk merren parasysh gjatë procesit buxhetor
	Ndikimi/Pasoja	Mos adresimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve Humbja e besimit të qytetarëve ndaj administratës Komunëe Rënie e interesit të qytetarëve për të paguar tatimet dhe taksat Komunëe
	Masat ekzistuese të kontrollit	Dëgjimet publike me qytetarët

<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	



ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	3
	Pasoja (1-5)	3
	Rezultati	9
	Prioriteti i rrezikut	Mesëm
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Të pa mjaftueshme
	Veprimi	Trajtim dhe zvogëlim
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Mbajtja e dëgjimeve të mjaftueshme publike me përfaqësuesit e të gjitha vendbanimeve Marrja në konsideratë e kërkesave dhe nevojave të qytetarëve përfshirë të gjitha grupet marginalizuara gjatë procesit buxhetor. Qasje aktive në informimin e qytetarëve për pjesëmarrje në dëgjimet publike gjatë procesit buxhetor.
	Forma e masave	Komunikim dhe informim i qytetarëve
	Burimet që kërkohen	Angazhimi stafit
	Pronari i rrezikut	DBF/ZKF
	Data e përfundimit	TM2 2019
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	Kuvendi Komunë – Komiteti për Politike dhe Financa Ministria e Financave
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I Ulët

<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	


	Numri i Referencës	3.4
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Politik
	Nën procesi	N/A
	Objektivi	<i>Buxhet gjithëpërfshirës, transparent në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të komunës dhe qeverisë, në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.</i>
	Ngjarja e rrezikut	Mos aprovimi i buxhetit nga Kuvendi Komunë
	Shkaku i Rrezikut	Buxheti nuk përfaqëson nevojat dhe kërkesat e komunitetit që përfaqësojnë asamblistët Buxheti nuk siguron zhvillim në fushat dhe nevojat prioritare
	Ndikimi/Pasoja	Komuna dështon të realizojë të gjitha projektet kapitale të planifikuara etj. Përkrahje jo e mjaftueshme e ekzekutivit nga kuvendi Komunë Objektivat e planit zhvillimor të komunës nuk arrihen dhe ka ngecje në zhvillim ekonomik Nevoja për përsëritje të procesit buxhetor
	Masat ekzistuese të kontrollit	Provizionet ligjore për afatet e aprovimit të buxhetit Komunë Proceset e diskutimeve buxhetore Komunë para aprovimit të buxhetit Rishikimi i projekt-buxhetit nga Komisioni për Financa
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	1
	Pasoja (1-5)	5
	Rezultati	5


<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	


	Prioriteti i rrezikut	I Ulët
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Të përshtatshme
	Veprimi	Monitorim, shmangie
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Përgatitja e buxhetit duke ndjekur një proces gjithëpërfshirës dhe transparent që adreson pritjet e qytetarëve dhe nevojat e komunës për zhvillim  Përfshirje e asamblistëve gjatë procesit të buxhetit veçanërisht gjatë takimeve me qytetarë dhe gjatë dëgjimeve buxhetore.
	Forma e masave	Plan i veprimit
	Burimet që kërkohen	Burime njerëzore
	Pronari i rrezikut	Kryetari i Komunës
	Data e përfundimit	TM2 2019
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	Kuvendi Komunë
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I Ulët


<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

4. PROCESI I BUXHETIT KOMUNË: DIAGRAMI I PROCESIT










Buxheti ka mospërputhje me kufinjë buxhetor dhe nuk aprovohet





## **II. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE**

## 1. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

<b>Titulli i procesit:</b>	Procesi i Menaxhimit të Pagave
<b>Organizata Buxhetore:</b>	Komuna Lipjan
<b>Data e rishikimit:</b>	<DATA>
<b>Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:</b>	Procesi përshkruan procedurat emenaxhimit të pagave në komunë përfshirë fazat si punësimi i punonjësve të rinj, koha dhe vijueshmëria, menaxhimi i listës së pagave, kalkulimi i pagave, pagesat, etj.
<b>Përgjegjësi për rishikim të procesit:</b>	Komuna
<b>Versioni:</b>	V. 01/2018
<b>Korniza ligjore:</b>	
<b>Pronari i Procesit:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kryetari i Komunës</li> <li>2. Menaxheri i Personelit</li> </ol>
<b>Palët e përfshira në proces:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kryetari i Komunës</li> <li>2. Punonjësit</li> <li>3. Menaxheri i BNJ</li> <li>4. Drejtorët e Drejtorive Përkatëse</li> <li>5. Thesari (divizioni i pagave)</li> <li>6. Zyrtari i shpenzimeve</li> <li>7. Ministria e Administratës Publike (MAP)</li> <li>8. Banka Qendrore e Kosovës (BQK)</li> </ol>
<b>Sistemet e TI të përfshira në proces:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. E-Mail</li> <li>2. SIMBNJ</li> <li>3. SMVP</li> </ol>
<b>Dokumentet e përfshira në proces:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Formulari standard i aplikimit</li> <li>2. Akt emërimi</li> <li>3. Kontrata</li> <li>4. Dokumenti elektronik për punonjës të rinj</li> <li>5. Kartela Magnetike për qasje në punë</li> <li>6. Listat e vijueshmërisë</li> <li>7. Urdhëresa për punë jashtë orarit</li> <li>8. Formulari i aprovimit të orëve të punuara jashtë orarit të rregullt</li> <li>9. Raportet e vijueshmërisë në punë</li> <li>10. Dokumentet mbështetëse (raportet mjekësore, etj.)</li> <li>11. Lista elektronike e punonjësve</li> <li>12. Urdhri për pagesë</li> <li>13. Urdhërpagesa</li> </ol>
<b>Ndërlidhja:</b>	Procesi i Buxhetit
<b>Numri i hapave:</b>	26

## 2. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE: PROCESI NË DETAJ

Procesi i Menaxhimit të Pagave						
Hapat	Aktiviteti	Aktivitetet e Kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet e gjeneruara	Sistemet
<b>Nën-Procesi: Krijimi (angazhimi) i punonjësve të rinj</b>						
1.	Regjistrimi i të dhënave të punonjësve të rinj në sistem të BNJ	<p>1.1 Pas përfundimit të procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësit të rinj, çdo punonjës i sapo punësuar ka plotësuar të dhënat e tij/saj personale në formatin standard të aplikacionit të BNJ (emri, mbiemri, datëlindja, numrin e letërnjoftimit, vendndodhjen, kombësinë, statusin civil, adresën, edukimi, profesioni, kualifikimet etj.)</p> <p>1.2 Të dhënat e plotësuara nga punonjësit dërgohen tek BNJ dhe inkorporohen ne SIMBNJ.</p>	1. Çdo punonjës	Pas përfundimit të procedurave të rekrutimit	<p>1.Të dhënat individuale dhe komponentët e pagës</p> <p>2.Aplikimi për transferin bankar</p> <p>3. Formulari standard i aplikimit</p>	Në letër
2.	Përgatitja e Akt emërimit nga Burimet Njerëzore	2.1 Pas përfundimit të procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësit të rinj, çdo punonjës i sapo emëruar plotëson të dhënat e tij/saj personale në formatin standard të BNJ (emri, mbiemri, datëlindja,	1. Menaxheri i BNJ	Nuk ka	1. Akt emërimit e punonjësit të ri	Në letër

		<p>numrin e letërnjoftimit, vendndodhjen, kombësinë, statusin civil, adresën, edukimi, profesioni, kualifikimet etj.)</p> <p>2.2 Menaxheri i BNJ përgatitë akt emërimin të punonjësit të ri në përputhje me katalogun e vendeve të punës dhe shpalljen.</p> <p>2.3 Menaxheri i BNJ e dërgon letrën e akt emërimin tek Kryetari i Komunës për nënshkrim</p>				
3.	Nënshkrimi i kontratës me punonjës in e ri	<p>3.1 Kryetari i komunës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nënshkruan akt emërimin;</li> <li>• Nënshkruan kontratën e punës me punonjës in e ri; dhe</li> </ul>	1. Kryetari i Komunës	Brenda 30 ditëve pas rekrutimit	<p>1.Akt emërimi i punonjës it të ri</p> <p>2.Kontrata</p>	<p>1. Në letër</p> <p>2. SIMBNJ</p>
4.	Dërgimi i dokumentacionit të punonjësve të rinj në MAP dhe regjistrimi i tyre në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ)	<p>4.1 Zyrtari i BNJ:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Skanon të gjitha dokumentet dhe i regjistron në SIMBNJ, ndërsa kopjet e dokumenteve të nevojshme i dërgon tek zyrtarët në MAP; dhe</li> <li>• Për qëllime të brendshme, krijon një bazë të thjeshtë të dhënash për punonjës it me informata si (emrin e institucionit, lokacionin,</li> </ul>	<p>1.Zyrtari përgjegjës i BNJ</p> <p>2. MAP</p>	Deri me datë 11 të muajit vijues	<p>1.Dokumentin elektronik për punonjës të rinj</p> <p>2. Formulari për punëtorë të rinj</p>	1. SIMBNJ

		departamentin, emrin mbiemrin, diplomat e fituara, datëlindjen, pozitën dhe shkallën e gradën e pagës)			3. Dokumentet në kopje fizike dërgohen në MAP	
<b>Nën-procesi: Koha dhe vijueshmëria</b>						
5.	Regjistrimi i punonjësve të rinj në Sistemin për Menaxhimin dhe Vijueshmërinë në Punë (SMVP)	5.1 Zyrtari i burimeve njerëzore informon departamentin e IT për stafin e ri  5.2 IT regjistron të dhënat personale të punonjësve të rinj në SMVP.	1. Zyrtari i BNJ	Nuk ka	1. Baza e të dhënave për vijueshmërinë në punë	SMVP
6.	Aprovimi i të dhënave për punonjësit e rinj në SMVP dhe krijimi i kartelës magnetike për regjistrimin e kohës	6.1 Menaxheri i BNJ i kontrollon dhe aprovon të dhënat e futura nga zyrtari i burimeve njerëzore në SMVP.  6.2 Menaxheri i BNJ krijon kartelën magnetike për regjistrim të vijueshmërisë dhe e pajis punonjësin e ri për qasje në vend të punës.	1. Zyrtari i BNJ	Nuk ka	1. Kartela magnetike	SMVP
7.	Regjistrimi manual i vijueshmërisë në punë (aty ku nuk aplikohet sistemi SMVP – ku ka prishje)	7.1 Menaxheri i drejtorisë përkatëse përgatitë dhe printon listat e hyrje daljes në baza ditore	1. Drejtori i drejtorisë përkatëse  1. Çdo punonjës	NA	1. Lista e vijueshmërisë	Letër

		<p>7.2 Menaxheri i drejtorisë përkatëse i vendosë listat në vend të përshtatshëm për nënshkrim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në mëngjes listat janë në dispozicion për nënshkrim deri në 15 minuta pas fillimit të orarit të punës.</li> <li>• Pas dite, listat janë në dispozicion për nënshkrim 10 para përfundimit të orarit të punës.</li> <li>• Në rast të ardhjes me vonesë ose daljes pas orarit të punës, vendoset ora e sakët e ardhjes/daljes nga puna.</li> </ul> <p>7.3 Drejtori i drejtorisë përkatëse i dërgon listat e nënshkruara të vijueshmërisë në punë tek BNJ.</p>				
8.	Evidentimi i nevojës për punë jashtë orarit dhe para autorizimi	<p>8.1 Drejtori i drejtorisë përkatëse evidenton nevojën dhe pajtohet për punë jashtë orarit.</p> <p>8.2 Drejtori i drejtorisë përkatëse autorizon kryerjen e punëve jashtë orarit përmes plotësimit të formularit Urdhëresa për Punë Jashtë Orarit”</p>	<p>1. Kryetari i Komunës</p> <p>2. Drejtori i drejtorisë përkatëse</p>	NA	1.Urdhëresa për Punë Jashtë Orarit	Në letër

9.	Konfirmimi i punës jashtë orarit	<p>9.1 Në rast të orëve shtesë jashtë orari të kryera nga stafi, drejtori i drejtorisë kontrollon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse orët shtesë të kryera bazohen në urdhëresën për punë shtesë jashtë orarit; dhe</li> <li>• Nëse puna zbatohet në përputhje me urdhëresën;</li> </ul> <p>9.2 Drejtori i drejtorisë përgatitë kërkesë zyrtare për aprovim të punëve të kryera jashtë orarit nga Kryetari i Komunës.</p>	1. Drejtori i drejtorisë përkatëse/udhëheqësi i njësisë	Pasi puna të kryhet	1. Formulari i aprovimit për orët e punuara jashtë orarit të punës	Në letër
10.	Raportimi i vijueshmërisë	10.1 Sipas kërkesës, menaxheri i BNJ gjeneron raporte mujore për vijueshmërinë e përditshme të çdo punonjësi të grupuara në drejtori. Raportet gjenerohen në SMVP ose listave të nënshkuara të vijueshmërisë (ku nuk përdoret SMVP).	1. Menaxheri i BNJ	NA	1. Raportet e gjeneruara të vijueshmërisë	1. SMVP
11.	Konfirmimi i vijueshmërisë	11.1 Drejtori i drejtorisë përkatëse: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrollon kohën e vijueshmërisë për secilin punonjës;</li> <li>• Siguron dokumentin e arsytimit mbështetës në rast të mungesës së punonjësit që ka nën mbikëqyrje; dhe</li> </ul>	1. Drejtori i drejtorisë përkatëse	Brenda datës 5 së muajit aktual	<p>1. Lista e vijueshmërisë e nënshkuar;</p> <p>2. Dokumentet mbështetëse në</p>	E-mail

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajton kërkesat e stafit të tij/saj për ri kalkulim të pagave nga muaji paraprak;</li> </ul> <p>11.2 Punonjësi konfirmon ose jo ndryshimet e kohës ose të prezencës</p>			<p>rast të mungesës në punë (raporti mjekësor, etj.)</p> <p>3. Rishikimin e kalkulimeve, etj.</p>	
<b>Nën-procesi: Menaxhimi i Listës së Pagave</b>						
12.	Përgatitja e listës së pagave	<p>12.1 Zyrtari i burimeve njerëzore përgatitë të dhënat për listën e pagave përmes formularit për të dhënat për listën e pagave për secilin punonjës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kodin institucional dhe buxhetor;</li> <li>• Lokacionin;</li> <li>• Departamentin;</li> <li>• Emrin dhe mbiemrin e punonjësve</li> <li>• Datëlindjen;</li> <li>• Kodi i pagesës;</li> <li>• Pozita dhe kodi i pagesës; dhe</li> <li>• Koeficienti.</li> </ul>	1. Zyrtari përgjegjës i burimeve njerëzore	Deri me datë 10 të muajit	1. Formulari i të dhënave për listën e pagave për secilin punonjës	1. SIMBNJ



13.	Përfshirja e ndryshimeve dhe pagave retroaktive në listën e pagave	<p>13.1 Për ndryshimet gjatë muajit dhe pagesat retroaktive, zyrtari i BNJ:</p> <p>13.2 Kontrollon dokumentet e pranuar të cilat autorizojnë ndryshimet; dhe</p> <p>13.3 Përgatitë një dokument të veçantë me të dhënat shtesë lidhur me</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zërin e ndryshuar në FDHLP;</li> <li>• Arsyetimin për ndryshimin përkatës; dhe</li> <li>• Datën e ndryshimit.</li> </ul>	1. Zyrtari i BNJ	Deri me datë 10 të muajit vijues	<p>1. Lista e ndryshimeve e krijuar nga zyrtari i BNJ</p> <p>2. Dokumentet mbështetëse (urdhri nga Kryetari i Komunës)</p> <p>3. Lista vijueshmërisë apo dokumenti i nënshkruar nga udhëheqësi i drejtorisë</p> <p>4. Raportet mjekësore, etj.</p>	1. Në letër
14.	Aprovimi i listës së pagave nga menaxheri i BNJ	<p>14.1 Menaxheri i BNJ:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryen kontrollin e dytë të formularit me të dhënat për pagat dhe listës së ndryshimeve (kontrolli i dokumenteve të</li> </ul>	1. Menaxheri i BNJ	Brenda datës 10 të muajit vijues	5. Dokumentet e dërguara në thesar	1. Në letër

		<p>bashkëngjitura të cilat dëshmojnë ndryshimet);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Konsultohet me ZKF nëse ka buxhet të alokuar në rast të orëve jashtë orarit të punës;</li> <li>• Aprovon dokumentet e përgatitura nga zyrtari i burimeve njerëzore; dhe</li> <li>• Në rast se nuk ka fonde për pagesë të orëve shtesë, ai/ajo kalkulon shumën përkatëse dhe i shndërron në ditë pushimi.</li> </ul> <p>14.2 Menaxheri i BNJ i dërgon dokumentet në thesar (divizioni i pagave) së bashku me referencat bankare.</p>				
15.	Kontrollimi nga Thesari (divizioni i pagave)	<p>15.1 Zyrtari përgjegjës i thesarit (divizioni i pagave) kontrollon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dokumentet e pranuar dhe i protokollon ato;</li> <li>• Regjistron FDHLP në sistem (një herë në muaj) dhe regjistron listën me ndryshime në SIP;</li> <li>• Kontrollon fizikisht dokumentet mbështetëse për punonjësit e rinj si kontratën, letër emërimin, etj.;</li> </ul>	1. Thesari (divizioni i pagave)	Nga data 11-18 të muajit	<p>1. Lista e protokollit të dokumenteve</p> <p>2. Lista elektronike e punonjësve publik</p>	Në SIMFK

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtron kontrole nëse punonjësi ka më shumë se dy vende të punës në administratë (lejohe vetëm një page primare dhe 1 sekondare);</li> <li>• Ushtron kontroll të dyfishtë me ATK për të dhënat e punonjësve prej regjistrimit civil (thesari ka çasje direkt në sistemin e tatimeve ku bashkëlidh me listën e punonjësve)</li> </ul>				
<b>Nën-procesi: Kalkulimi i pagave</b>						
16.	Kontrolli buxhetor	<p>16.1 Zyrtari i thesarit siguron:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrollin automatik të buxhetit përmes sistemit (kontrollon numrin e punonjësve për secilin drejtor kundrejt numrit total të aprovuar në buxhet);</li> <li>• Kalkulimin automatik të pagave; dhe</li> <li>• Gjenerimin e listës së pagave në sistemin e pagave (në hollësi përfshirë orët jashtë orarit dhe bonuset) për secilin punonjës dhe të gjitha zbritjet lidhur me sigurimet sociale, tatimin në të</li> </ul>	1. Thesari (divizioni i pagave)	NA	NA	1. SIMFK

		ardhura, pagesat e sindikatave, etj.				
17.	Nënshkrimi i listës së pagave	<p>17.1 Menaxheri i BNJ printon listat e pagave nga sistemi i pagave dhe ua dërgon drejtorive përkatëse. <i>(Menaxheri i BNJ ka qasje në sistem të pagave në thesar)</i></p> <p>17.2 Secili punonjës nënshkruan listat e pagave</p> <p>17.3 Drejtori i drejtorisë përkatëse i dërgon listat e nënshkruara tek BNJ</p> <p>17.4 Menaxheri i BNJ dërgon tek ZKF/Zyrtari i shpenzimeve listat e pagave dhe urdhrin për pagesë</p>	1.Menaxheri i BNJ	Nga data 23 -25 e muajit	<p>1. Listat e pagave të firmosura</p> <p>2. Urdhri për pagesë</p>	1. Në letër

18.	Kontrollimi/korrigjimi i pagës në listë të pagave	18.1 Çdo punonjës e kontrollon pagën e tij (kalkulimi, ndalesat, etj.) dhe në rast të mospajtimit mund të bëjë kërkesë për rishikim të pagës të cilën e dërgon tek menaxheri i BNJ	1.Çdo punonjës	Në muajin pasues	1. Kërkesë për rishikim të kalkulimit të pagës	E-mail ose në letër
19.	Regjistrimi i shpenzimeve të pagave në SIMFK	19.1 Zyrtari i shpenzimeve merr listën e pagave dhe urdhrin për pagesë nga menaxheri i BNJ dhe i firmos së bashku me Kryetarin e Komunës.  19.2 Zyrtari i shpenzimeve regjistron shumën totale të pagave në SIMFK	1. Zyrtari i shpenzimeve	NA	1.Listat e pagave 2. Urdhri për pagesë	1. Në letër
<b>Nën-procesi: Pagesat e Pagave dhe barazimet</b>						
20.	Kontrolli i listës së pagave nga njësia e pagesave në Thesar	20.1 Pas pranimit të listës së pagave të komunës, zyrtari i thesarit përgjegjës për pagesa kontrollon: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numrin total të punonjësve dhe shumën totale të pagave kundrejt buxhetit vjetor dhe alokimit mujor për pagat.</li> </ul> 20.2 Njofton ZKF në rast se mungojnë fondet në SIMFK	1. Thesari njësia e pagesave	24 - 30 të muajit vijues	1. Plani i alokimit mujor i rishikuar	1. SIMFK

		<p>20.3 Pas pranimit të njoftimit për mungesë të fondeve, ZKF:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rishikon planin e parasë së gatshme (alokimi i fondeve); dhe</li> <li>• Në rast se shuma e pagave për t'u paguar është më e vogël gjatë muajit dhe bën rregullimet e nevojshme</li> </ul>				
21.	Përgatitja e pagesës së pagave	<p>21.1 Pas kontrollit të kryer nga njësia e pagesave, zyrtari i Thesarit për paga përgatitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bllloqe të veçanta pagesash (files) për secilën bankë komerciale; dhe</li> <li>• Transferet bankare në llogaritë e punonjësve.</li> </ul>	1. Thesari	Dita e parë e punës muajit në vijim	1. Pagesat elektronike	1.SIMFK- SIP
22.	Aprovimi i pagesës së pagave nga Drejtori i Thesarit dhe ekzekutimi i tyre	<p>22.1 Zyrtari i Thesarit përgjegjës për pagësa përgatitë urdhër pagesat (shumat totale) për çdo bankë komerciale;</p> <p>22.2 Drejtori i Thesarit aprovon urdhër pagesat;</p> <p>22.3 Zyrtari i Thesarit për pagesa dërgon në BQK për ekzekutim transferin e</p>	1. Thesari	Deri në fund të muajit	1. Urdhërpagesa	1. Në letër 2. SIMFK

		<p>parasë së gatshme në secilën bankë komerciale; dhe</p> <p>22.4 Zyrtari përgjegjës i Thesarit regjistron shpenzimet dhe pagesën e pagave në SIMFK;</p>				
23.	Kontrolli i ekzekutimit të pagave dhe barazimi i gabimeve	<p>23.1 Thesari (Divizioni i Pagesave):</p> <p>23.2 Merr pasqyrën e gjendjes ditore të LLFK nga BQK së bashku me dokumentin elektronik të gabimeve (në rast të pagesave të kthyera mbrapsht) dhe njofton organizatën buxhetore; dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bën barazimet ndërmjet sistemeve të SIMFK dhe BQK-së si dhe ndërmjet SIMFK dhe sistemit të pagave</li> </ul>	1.Thesari	Maksimumi në ditën në vijim	1. Pagesa të kthyera (Dokumentet elektronike)	1. SIMFK-SIP
24.	Trajtimi i gabimeve në transfer të pagave nga Komuna	<p>24.1 Zyrtari i shpenzimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeneron raportin e pagesave ditore; dhe</li> <li>• Printon dokumentin e gabimeve (pagesave të kthyera)</li> </ul>	1. Zyrtar i shpenzimeve	Çfarëdo kohe pas datës 1 të muajit	1. Dokumenti i gabimeve (pagesave të kthyera)	1. SIMFK

		24.2 Zyrtari i shpenzimeve e dërgon dokumentin e gabimeve të Menaxheri i BNJ				
25.	Korrigjimi i gabimeve të transferit të pagave nga Komuna	25.1 Menaxheri i BNJ: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndjek hapat e përshkruara më sipër në pjesën Menaxhimi i Listës së Pagave; dhe</li> <li>• Paraqet pagesat retroaktive në listën e ndryshimeve të muajit vijues.</li> </ul>	1. Menaxheri i BNJ	Nuk ka	1. Lista e ndryshimeve në Thesar (divizioni i pagave)	E-mail ose letër
<b>Fundi i procesit të Menaxhimit të Pagave</b>						



### 3. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE: LISTA E RREZIQEVE

3.1 Dështimi për të punësuar dhe ruajtur stafin e kualifikuar dhe me përvojë në fusha deficitare

3.2 Rrjedhja dhe keqpërdorimi i pa autorizuar i të dhënave personale të të punësuarave

3.3 Mos vlerësimi i performancës së punës

3.4 Rekrutimi/avancimi apo pagesa e stafit bazuar në dokumentacion të pa verifikuar

	Numri i Referencës	3.1
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Strategjik, Operativ, Menaxherial
	Nën procesi	Angazhimi i punonjësve të rinj
	Objektivi	<i>Menaxhimi i burimeve njerëzore (rekrutimi, trajnimi, vlerësimi etj.) në mënyrë transparente, objektive, meritorë dhe në përputhje me objektivat strategjike, dhe legjislacionin në fuqi</i>
	Ngjarja e rrezikut	<b>Dështimi për të punësuar dhe ruajtur stafin e kualifikuar dhe me përvojë në fusha deficitare</b>
	Shkaku i Rrezikut	Buxhet i limituar për kompensim të stafit Rekrutimi i stafit jo në bazë të meritës Mundësi të limituara për zhvillim profesional dhe avancim në karrierë
	Ndikimi/Pasoja	Shërbime të cilësisë së dobët Dështimi në realizimin e objektivave Komunëe Mungesa e ekspertizës së brendshme dhe nevoja për të kontraktuar shërbimet nga jashtë
	Masat ekzistuese të kontrollit	Procedura të hapura të rekrutimit

<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

		Caktimi i komisioneve të rekrutimit Vendosja
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	3
	Pasoja (1-5)	3
	Rezultati	9
	Prioriteti i rrezikut	Mesëm
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Jo të mjaftueshme
	Veprimi	Trajtim dhe zvogëlim
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Përmirësimi i kontrolleve gjatë rekrutimit të stafit Krijimi i mundësive për zhvillim profesional dhe avancim në karrierë Angazhimi i stafit profesional dhe të pavarur në komisione të rekrutimit Zhvillimi i kriterëve objektive të përzgjedhjes dhe zbatimi i tyre gjatë rekrutimit
	Forma e masave	Rishikimi i kontrolleve Plan veprimi për trajnime
	Burimet që kërkohen	Angazhimi stafit, burime financiare
	Pronari i rrezikut	Menaxheri i Burimeve njerëzore
	Data e përfundimit	I vazhdueshëm

**Mundësia** 1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe

2- Pak e mundur

3- Ka mundësi

4- Me shumë mundësi

5- Pothuajse e sigurt

**Ndikimi** 1- Të pa përfillshme

2- Të vogla

3- Moderuara

4- Të mëdha

5- Katastrofike

**Rezultati** 0 - 5 Rreziku i ulët

6 – 10 Rreziku i mesëm

12 – 16 Rreziku i lartë

20 – 25 Rreziku ekstrem

**Rangimi** I Ulët

I Mesëm

I Lartë

Ekstrem

	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	MAP
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët

	Numri i Referencës	3.2
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Operacional, Punonjësit, Menaxherial
	Nën procesi	Menaxhimi i personelit
	Objektivi	<i>Menaxhimi i burimeve njerëzore (rekrutimi, trajnimi, vlerësimi etj.) në mënyrë transparente, objektive, meritore dhe në përputhje me objektivat strategjike, dhe legjislacionin në fuqi</i>
	Ngjarja e rrezikut	<b>Rrjedhja dhe keqpërdorimi i pa autorizuar i të dhënave personale të të punësuarave</b>
	Shkaku i Rrezikut	Çasje e pa autorizuar në të dhënat personale Shpalosja e qëllimshme e të dhënave personale Mungesa e kontrolleve të duhura të teknologjisë informative
	Ndikimi/Pasoja	Keqpërdorimi i të dhënave personale nga palët e treta Keqpërdorimi i llogarive bankare të stafit Cenimi i privatësisë së stafit Humbja e besimit dhe dëmtimi i reputacionit të komunës
	Masat ekzistuese të kontrollit	Kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale

<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

		Çasje e kufizuar në të dhënat personale të të punësuarve Ruajtja e dosjeve të personelit
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	4
	Pasoja (1-5)	4
	Rezultati	16
	Prioriteti i rrezikut	Lartë
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Jo të mjaftueshme
	Veprimi	Trajtimi dhe zvogëlimi
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Forcimi i kontrolleve të teknologjisë informative Limitimi i qasjes në dhënat personale Trajnimi i stafit në ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale Kujdes i shtuar i stafit përgjegjës gjatë procesimit dhe ruajtjes së të dhënave personale
	Forma e masave	Zbatim i kërkesave ligjore Plan veprimi
	Burimet që kërkohen	Angazhim i shtuar i stafit, burime financiare
	Pronari i rrezikut	Menaxheri i Burimeve Njerëzore
	Data e përfundimit	I vazhdueshëm

<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	MAP, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët

	Numri i Referencës	3.3
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Menaxheriale, Pajtueshmëri
	Nën procesi	Menaxhimi i personelit
	Objektivi	<i>Menaxhimi i burimeve njerëzore (rekrutimi, trajnimi, vlerësimi etj.) në mënyrë transparente, objektive, meritore dhe në përputhje me objektivat strategjike, dhe legjislacionin në fuqi</i>
	Ngjarja e rrezikut	<b>Mos vlerësimi i performancës së punës</b>
	Shkaku i Rrezikut	Kuptimi i dobët i rëndësisë së vlerësimit të performancës Mos interesimi i menaxhmentit për vlerësimin e performancës Mungesa aftësive për vlerësim objektiv të performancës
	Ndikimi/Pasoja	Dështimi për të identifikuar performancën e dobët dhe nevojave për zhvillim dhe trajnim Dështimi për të identifikuar performuesit e mirë Avancimi i stafit jo i bazuar në performancë dhe rezultate në punë Mos zbatimi i kërkesave ligjore për vlerësim të performancës në punë
	Masat ekzistuese të kontrollit	Kërkesat ligjore për vlerësim të performancës

<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

		Njoftimi nga zyra e personelit për kërkesat ligjore për vlerësim të performancës
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	3
	Pasoja (1-5)	4
	Rezultati	12
	Prioriteti i rrezikut	Lartë
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Jo të mjaftueshme
	Veprimi	Trajtimi dhe zvogëlimi
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Hartimi i një plani për kryerjen e vlerësimit të rregullt të performancës së stafit dhe zbatimi i tij Trajnimi i stafit për kryerjen e vlerësimit të performancës Promovimi i një kulture organizative të bazuar në performancë
	Forma e masave	Plani kohor për vlerësimin e performancës
	Burimet që kërkohen	Angazhimi i stafit
	Pronari i rrezikut	Drejtorët e Drejtorive përkatëse
	Data e përfundimit	TM4
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	MAP
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët

<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	

	Numri i Referencës	3.4
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Rregullator, Punonjësit
	Nën procesi	N/A
	Objektivi	<i>Menaxhimi i burimeve njerëzore (rekrutimi, trajnimi, vlerësimi etj.) në mënyrë transparente, objektive, meritore dhe në përputhje me objektivat strategjike, dhe legjislacionin në fuqi.</i>
	Ngjarja e rrezikut	<b>Rekrutimi/avancimi apo pagesa e stafit bazuar në dokumentacion të pa verifikuar</b>
	Shkaku i Rrezikut	Veprimet e qëllimshme Kontrolle të pa mjaftueshme Pakujdesia e stafit gjatë procesit
	Ndikimi/Pasoja	Rekrutimi i stafit jo adekuat Mos kryerja e punëve apo kryerja e tyre të cilësisë së dobët Ankesa ndaj procesit të rekrutimit Dëmtimi i reputacionit të komunës
	Masat ekzistuese të kontrollit	Rregullorja për angazhimin e stafit të shërbimit civil, komisionet vlerësuese dhe raportet e vlerësimit të kandidatëve
ANALIZ A E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	2
	Pasoja (1-5)	4


<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	


	Rezultati	8
	Prioriteti i rrezikut	Mesëm
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Të pa përshtatshme
	Veprimi	Trajtimi dhe shmangia
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Përfshirja e kërkesave për verifikim të dokumentacioneve gjatë rekrutimit përfshirë kontaktin me lëshuesit e dokumentacionit Kujdes i shtuar gjatë shqyrtimit të dokumentacionit Kërkesa për dokumentacion shtesë
	Forma e masave	Plan veprimi, ndryshim rregullativ, monitorim
	Burimet që kërkohen	Njerëzore
	Pronari i rrezikut	Menaxheri i Burimeve Njerëzore
	Data e përfundimit	I vazhdueshëm
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	MAP
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët


<b>Mundësia</b>	1- Pothuajse e sigurt s'ndodhe	2- Pak e mundur	3- Ka mundësi	4- Me shumë mundësi	5- Pothuajse e sigurt
<b>Ndikimi</b>	1- Të pa përfillshme	2- Të vogla	3- Moderuara	4- Të mëdha	5- Katastrofike
<b>Rezultati</b>	0 - 5 Rreziku i ulët	6 – 10 Rreziku i mesëm	12 – 16 Rreziku i lartë	20 – 25 Rreziku ekstrem	
<b>Rangimi</b>	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	Ekstrem	




#### 4. PROCESI I MENAXHIMIT TË PAGAVE: DIAGRAMI I PROCESIT









### **III. PROCESI I KONTRATAVE PËR SHËRBIME ME MARRËVESHJE TË VEÇANTA**

## 1. PROCESI I KONTRATAVE PËR SHËRBIME ME MARRËVESHJE TË VEÇANTA: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

<b>Titulli i procesit:</b>	Procesi i angazhimit të stafit përmes kontratave për shërbime me marrëveshjeve të veçanta
<b>Organizata Buxhetore:</b>	Komuna Lipjan
<b>Data e rishikimit:</b>	<01.07.2021>
<b>Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:</b>	Procesi ka për qëllim përshkrimin e procedurave të angazhimit të stafit me kontrata për marrëveshje për shërbimeve të veçanta. Procesi përshkruan procedurat prej fazës së planifikimit, shpalljes, përzgjedhjes, angazhimit dhe monitorimit.
<b>Përgjegjësi për rishikim të procesit:</b>	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
<b>Versioni:</b>	V. 01/2021
<b>Korniza ligjore:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Buxheti komunal</li> <li>2. Ligji për zyrtarët publik 06-L-114</li> <li>3. Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042</li> <li>4. Rregullat për prokurim të Shërbimeve të Veçanta (konsulentët/kontraktorët individual)</li> <li>5. Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik</li> </ol>
<b>Pronari i Procesit:</b>	Zyrtari përgjegjës i Prokurimit
<b>Palët e përfshira në proces:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kryetari i Komunës</li> <li>2. Njësia Kërkuese/Drejtoria Përkatëse</li> <li>3. Zyrtari përgjegjës i prokurimit</li> <li>4. Drejtori për Buxhet dhe Financa/Zyrtari Kryesor Financiar</li> <li>5. Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve</li> <li>6. Komisioni Rregullativ i Prokurimit publik</li> <li>7. Organi i Shqyrtues i Prokurimit (OSHP)</li> <li>8. Përfituesit e Kontratës</li> </ol>
<b>Sistemet e TI të përfshira në proces:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. E-Mail</li> <li>2. SIMFK</li> </ol>
<b>Dokumentet e përfshira në proces:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Buxhet preliminar për staf me marrëveshje për shërbime të veçanta</li> <li>2. Kërkesa për angazhim e stafit me marrëveshje me shërbime të veçanta</li> <li>3. Specifikacionet teknike dhe termat e references</li> <li>4. Shpallja e publikuar</li> <li>5. Procesverbali/ regjistri i aplikacioneve</li> <li>6. Vendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për Vlerësim të Aplikacioneve</li> <li>7. Raporti i vlerësimit të komisionit vlerësues</li> <li>8. Formulari B58 "Njoftimi mbi vendimin e AK"</li> <li>9. Vendimi i autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës</li> </ol>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>10. DNPDP</li> <li>11. Letrat standarde</li> <li>12. Kërkesa për rishqyrtim nga aplikuesit/pjesëmarrësit e procesit</li> <li>13. Vendimi i OSHP-së</li> <li>14. Pjesa II e DNPDP e nënshkruar</li> <li>15. Njoftimi për dhënie të kontratës</li> <li>16. Kontrata e nënshkruar</li> <li>17. Njoftimi për nënshkrim të kontratës</li> </ul>
<b>Ndërlidhja:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>1. Procesi i buxhetit</li> <li>2. Procesi mallrave dhe shërbimeve</li> </ul>
<b>Numri i hapave:</b>	18

## 2. PROCESI I KONTRATAVE PËR SHËRBIME ME MARRËVESHJE TË VEÇANTA: PROCESI NË DETAJ

Procesi i angazhimi të stafit përmes kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta						
Hapa t	Aktivitetet	Aktivitetet e kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet gjeneruara	Korniza ligjore
1.	Planifikimi buxhetor për angazhim të personelit me marrëveshje për shërbime të veçanta	<p>1.1. Gjatë planifikimit buxhetor, drejtorët e drejtorive përkatëse duhet të parashohin:</p> <p>1.1.1. Nevojat specifike për shërbime të veçanta sipas planit të tyre strategjik dhe të punës për vitin vijues.</p> <p>1.1.2. Numrin e stafit të nevojshëm për angazhim me kontrata me marrëveshje për shërbime të veçanta (jo me shume se 36 muaj).</p> <p>1.1.3. Rezultatet e pritura të punës të stafit të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta.</p> <p>1.1.4. Koston e përafërt të angazhimit të stafit dhe kualifikimet e nevojshme për të</p>	<p>1. Drejtorët e Drejtorive Përkatëse</p> <p>2.ZKF/Drejtori për Financa</p> <p>3. Kryetari i Komunës</p>	Jo më vonë se para datës së pranimit të qarkores se parë buxhetore për vitin vijues	1. Buxhet preliminar për staf me marrëveshje për shërbime të veçanta	1. Buxheti komunal Komuna e Deçanit



		<p>ekzekutuar detyrat e kontratës së paraparë.</p> <p>1.1.5. Buxhetimin për kostot e punësimit të personelit nëpërmjet marrëveshjeve për shërbime të veçanta.</p>				
2.	<p>Arsyetime i nevojës për staf me marrëveshje për shërbime të veçanta</p>	<p>2.1. Drejtori i Drejtorisë përkatëse përgatitë Kërkesën për Angazhimin e Stafit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta.</p> <p>2.2. Kërkesa duhet të përfshijë së paku këto informata:</p> <p>2.2.1. Arsyet për nevojën për të angazhuar stafin nëpërmjet marrëveshjeve për shërbime të veçanta;</p> <p>2.2.2. Arsyet përse shërbimet nuk mund të kryhen nga kapacitetet e brendshme të Komunës;</p> <p>2.2.3. Problemet dhe mundësitë e humbura</p>	<p>1. Drejtori i Drejtorisë Përkatëse</p>	<p>Nuk ka</p>	<p>1. Kërkesa për Angazhimin e Stafit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta.</p>	<p>1. Ligji për zyrtarët publik 06-L-114</p> <p>2. Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042</p>

		<p>që mund të rrjedhin nga mos-përmbushja e kërkesës për angazhim të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta;</p> <p>2.2.4. Periudha kohore për përfundimin e angazhimit të stafit;</p> <p>2.2.5. Kohëzgjatja e pritur e angazhimit të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta nuk mund të jete me shume se 36 muaj;</p> <p>2.2.6. Përshkrimin e përgjegjësive të angazhimit dhe kërkesat minimale të kualifikimeve dhe eksperiencës.</p>				
3.	Aprovimi i kërkesës nga Kryetari i Komunës	3.1. Drejtori i Drejtorisë përkatëse dërgon kërkesën për angazhim të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta te Kryetari i Komunës për aprovim.	1. Drejtori i Drejtorisë përkatëse  2. Kryetari i Komunës	Nuk ka	1. Kërkesa për Angazhimin e Stafit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e aprovuar	1. Analogjia sipas Rregulles per prokurim te Sherbimeve te Veçanta (konsulentet/kontraktoret individual) dhe Rregulles dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik

		<p>3.2. Kryetari i Komunës shqyrton kërkesën dhe aprovon ose refuzon atë.</p> <p>3.3. Nëse kërkesa aprohet, kërkesa dërgohet ne zyren e prokurimit për procedura të rekrutimit.</p> <p>3.4. Nëse kërkesa refuzohet, procesi ndalohet dhe duhet të fillojë nga pika 2.</p>				
4.	Përgatitja/propozimi specifikacioneve teknike dhe termave te references për angazhim me marrëveshje për shërbime të veçanta	<p>4.1. Njesia e kerkeses përgatitë specifikacionet teknike dhe termat e references per aplikim.</p> <p>4.2. Specifikacioni teknik dhe termat e references duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Rregulles per prokurim te</p>	1. Njesia e kerkeses	Nuk ka	1. Specifikacionet teknike dhe termat e references	1. Analogjia sipas Rregulles per prokurim te Sherbimeve te Veçanta (konsulentet/kontraktoret individual) dhe Rregulles dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik

		Sherbimeve te Veqanta (konsulentet/kontraktoret individual) dhe Rregulles dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik				
5.	Përgatitja dhe publikimi i shpalljes për angazhim të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta.	<p>5.1. Zyrtari pergjegjes i prokurimit përgatit publikimin e njoftimit per kontrate për angazhim të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta sipas kërkesave të Rregulles per prokurim te Sherbimeve te Veqanta (konsulentet/kontraktoret individual) dhe Rregulles dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik.</p> <p>5.2. Publikimi i njoftimit per kontrate behet ne platformen elektronike ne perputhje me nenin 40 te Ligjit per prokurim publik dhe me ngarkimin e dosjes se</p>	1. Zyra e prokurimit	Nuk ka	1. Shpallja nëpërmjet platformes elektronike e-prokurimit	1. Analogjia sipas Rregulles per prokurim te Sherbimeve te Veqanta (konsulentet/kontraktoret individual) dhe Rregulles dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik.

		<p>tenderit te miratuar nga KRPP.</p> <p>5.3. Kohëzgjatjen e angazhimit (jo me shume se 36 muaj).</p> <p>5.4. Datën e mbylljes së konkurrimit dhe informata mbi datën e fundit për dorëzimin e aplikacioneve (siq eshte e percaktuar ne dispozitat e Rregulles dhe udhezuesit per prokurim publik. Afati i dhënë kofor duhet të varet prej objektit të kontratës që duhet dhënë si dhe nuk duhet të jetë më pak se 20 ditë për kontrat me vlerë të mesme, si dhe jo më pak se 40 ditë për kontrata me vera të mëdha. ).</p>				
6.	Pranimi i aplikacioneve	6.1. Zyrtari pergjegjes i prokurimit i pranon aplikacionet permes platformes elektronike te prokurimit.	1. Zyrtari pergjegjes i prokurimit	Pas mbylljes së afatit të aplikimit	1. Procesverbali/ regjistri i aplikacioneve	1. Analogjija sipas Rregulles per prokurim te Sherbimeve te Veqanta (konsulentet/kontraktoret individual) dhe Rregulles dhe

		6.2. Pas pranimet të aplikacioneve, krijohet procesverbali/regjistri i aplikacioneve të pranuar.				udhëzuesit operativ për prokurimin publik.
7.	Krijimi i Komisionit Vlerësues	<p>a. Kryetari i Komunës në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit krijon komisionin vlerësues.</p> <p>b. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të bëjë rekomandimin për anëtar të Komisionit Vlerësues dhe i dërgon rekomandimet për anëtar tek Kryetari i Komunës.</p> <p>7.3 Kryetari i Komunës bën aprovimin apo refuzimin e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Aplikacioneve, ose kur është e nevojshme do të zgjedh antarë alternativ për Komisionin.</p> <p>7.4 Vendimi i formimit të Komisionit i dërgohet</p>	<p>1. Kryetari i Komunës</p> <p>2. Zyrtari përgjegjës i prokurimit</p>	Brenda 48 orëve pas pranimet të aplikacioneve.	1. Vendimi për caktimin e komisionit vlerësues	<p>1. Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik</p>

		anëtarëve të Komisionit Vlerësues.				
8.	Shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikacioneve	<p>8.1. Pas pranimit të vendimit për formimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikacioneve, komisioni vlerësues fillon menjëherë me vlerësimin e aplikacioneve duke marr parasysh disa kritere, sikurse janë të përcaktuara në Nenin 4 të Rregullës për prokurim të shërbimeve të veqanta (konsulentët/kontraktoret individual). .</p> <p>a. Piket totale do të fitohen duke bashkuar piket teknike dhe financiare. Notat e “kostos” duhet të përzgjidhen duke marr parasysh ndërlíkueshmerinë e objektit të kontratës që duhet dhënë si dhe rëndësinë përkatëse të</p>	1. Komisioni vlerësues	<p>1. Vlerësimi fillon menjëherë pas pranimit të aplikacioneve dhe jo më vonë se 5 dite pas pranimit të aplikacioneve</p> <p>2. Vlerësimi i ofertave përfundon jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i vlerësimit të aplikacioneve nga Komisioni Vlerësues</p> <p>3. Në raste të jashtëzakonsh me afati i vlerësimit të aplikacioneve mund të zgjatet</p>	1. Raporti i vlerësimit të komisionit vlerësues	<p>1. Analogjia sipas Rregulles per prokurim te Shërbimeve te Veqanta (konsulentet/kontraktoret individual) dhe Rregulles dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik, dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.</p>

		<p>cilësisë. Rezultati i peshuar i propozimit financiar duhet të specifikohet në Dosje te Tenderit, dhe mund të jetë deri në 30 pikë.</p> <p>b. Komisioni pas përfundimit të procedurave të vlerësimit krijon raportin e vlerësimit me anë të të cilit i rekomandon zyrtarit përgjegjës të prokurimit cili nga aplikimet duhet të shpërblehet me kontratë.</p>		edhe për 20 ditë shtesë		
9.	Aprovimi i vlerësimit nga zyrtari përgjegjës i prokurimit	<p>9.1. Raporti i vlerësimit aprovet nga Zyrtari përgjegjës i prokurimit.</p> <p>9.1.1.Nëse Zyrtari përgjegjës nuk pajtohet, ai/ajo mund të kërkojë rivlerësim ose mund të nxjerr vendimin perfundimtar</p> <p>9.1.2.Shpjegimi i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. Informacioni duhet të jepet me shkrim.</p>	1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit.	Pas kryerjes së vlerësimit	1. Raporti i vlerësimit	<p>1.Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042</p> <p>2.Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik</p>



10.	Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues	<p>10.1. Pas identifikimit të aplikacionit më të mirë, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit, duhet që të përgatitë Formularin B58 “Njoftimin mbi vendimin e AK” dhe ta ngritë në platformë të prokurimit elektronik</p> <p>10.2. Në këtë fazë bëhet rikonfirmimi i fondeve përmes DNPDF pjesa e III-të</p>	<p>1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit</p> <p>2. Kryetari i Komunës</p> <p>3. ZKF</p>	Pas rekomandimit për dhënie të kontratës	<p>1. Formulari B58 “Njoftimi mbi vendimin e AK”</p> <p>2. Vendimi i autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës</p> <p>3. Ri-konfirmimi i DNPDF</p>	<p>1. Analogjija sipas Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042</p> <p>2. Rregulles per prokurim te Sherbimeve te Veqanta (konsulentet/kontraktoret individual) dhe Rregulles dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik</p> <p>3. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik</p>
11.	Dërgimi i njoftimit tek aplikuesit	11.1. Përfituesi i kontratës dhe të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurë të prokurimit njoftohen përmes sistemit elektronik të prokurimit publik të Kosovës	1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit.	Menjëherë	1. Letrat standarde	<p>1. Analogjija sipas Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik</p>
12.	Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim në komunë	12.1. Aplikuesit e pa kënaqur, mund të parashtrajnë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues brenda 5	1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit	Brenda 5 ditëve pas datës së njoftimit te aplikuesve mbi	1. Kërkesa për rishqyrtim nga aplikuesit/pjesëmarrësit e procesit	<p>1. Analogjija sipas Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ</p>

		<p>ditëve nga publikimi i njoftimit për vendimin të autoritetit kontraktues.</p> <p>12.2. Nëse paraqitet kërkesa për rishqyrtim, procedura e prokurimit pezullohet dhe të gjithë pjesëmarrësit në procedurë njoftohen.</p> <p>12.3. Pezullimi i procedurës përfundon menjëherë pasi komuna të merr vendim për kërkesën për rishqyrtim.</p> <p>12.4. Komuna shqyrton kërkesën e aplikuesëve/pjesëmarrësve në proces brenda 3 ditëve punë respektivisht 6 ditëve nga pranimi i saj.</p> <p>12.5. Komuna, mund, me anë të një vendimi:</p> <p>12.5.1. Të refuzojë kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabazë; ose</p> <p>12.5.2. Të miratojë një kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar.</p>	rezultatet e prokurimit		për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
--	--	--	-------------------------	--	---

		<p>12.6. Vendimi i komunës është i detyrueshëm për komunën dhe duhet të zbatohet menjëherë.</p> <p>12.7. Vendimi i komunës i komunikohet në formë elektronike parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara pjesëmarrës në prokurimin në fjalë e shohin atë në sistem elektronik të prokurimit të Kosovës.</p>				
13.	Paraqitja e ankesës pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)	<p>13.1. Në rast se operatori ekonomik nuk është i kënaqur me vendimin e marrë nga komuna, mund të parashtror ankesë pranë OSHP-së.</p> <p>13.2. Ankesa duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga komuna në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.</p> <p>13.3. Dorëzimi i ndonjë ankese e obligon komunën që automatikisht ta pezullojë</p>	1. OSHP	Brenda 10 ditëve pas datës së njoftimit të aplikuesëve mbi rezultatet e prokurimit	<p>1. Kërkesa për rishqyrtim nga aplikuesit/pjesëmarrësit e procesit</p> <p>2. Vendimi i OSHP-së</p>	<p>1. Analogjia sipas Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042</p> <p>2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik</p>

		<p>zbatimin e aktivitetit të prokurimit.</p> <p>13.4. OSHP jep përgjigje ndaj ankesës brenda 34 ditëve nga pranimi i ankesës.</p> <p>13.5. OSHP mund të vendos/kërkoj:</p> <p>13.5.1. Ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve;</p> <p>13.5.2. Të rekomandoj autoritetit kontraktues të vazhdoj me dhënien e kontratës.</p>				
14.	Konfirmimi i procedurës së prokurimit, buxhetit, dhe nevojës	<p>14.1. Para dorëzimit të letrave standarde dhe para publikimit të vendimit të AK përmes nënshkrimit të pjesës së III të DNPDP bëhen ri konfirmimet si në vijim:</p> <p>14.1.1. Zyrtari përgjegjës konfirmon se aktiviteti i prokurimit ka qenë në përputhje me ligjin e prokurimit publik.</p>	<p>1. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit</p> <p>2. DBF/ZKF</p> <p>3. Kryetari i Komunës</p>	Para dorëzimit të letrave standarde dhe para publikimit të vendimit të AK	1. Pjesa II e DNPDP e nënshkruar	<p>1. Analogjija sipas Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042</p> <p>2. Rregulles për prokurim të Sherbimeve të Veçanta (konsulentet/kontraktor et individual) dhe Rregulles dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik</p> <p>3. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni</p>

		14.1.2. DBF/ZKF ri konfirmon se buxhet i zotuar më herët është në dispozicion; dhe 14.2. Kryetari i Komunës ri konfirmon se prokurimi në fjalë është ende i nevojshëm.				Rregullativ i Prokurimit Publik
15.	Publikimi i njoftimit për dhënie të kontratës	15.1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit publikon njoftimin për dhënie të kontratës përmes sistemit elektronik të prokurimit publik të Kosovës.	1. Zyrtari përgjegjës i prokurimit.	Brenda 2 ditëve pasi që është pranuar nga KRPP	1. Njoftimi për dhënie të kontratës	1. Analogjija sipas Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 2. Rregulles për prokurim të Sherbimeve të Veçanta (konsulentet/kontraktoret individual) dhe Rregulles dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik 3. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
16.	Nënshkrimi i kontratës	16.1. Zyrtari përgjegjës nënshkruan kontratat për mallra dhe shërbime deri në 125,000 EUR dhe kontratat për punë deri në 500,000 EUR. 16.2. Kontratat me vlera të mëdha (mbi 125,000 EURO	1. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit 2. Kryetari i Komunës	Pas skadimit të afatit të ankesave	1. Kontrata e nënshkruar	1. Analogjija sipas Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042 2. Rregulles për prokurim të Sherbimeve të Veçanta (konsulentet/kontraktoret individual) dhe Rregulles dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik

		respektivisht 500,000 EUR) nënshkruhen nga Zyrtari përgjegjës dhe Kryetari i Komunës.				3. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
17.	Publikimi i njoftimit për nënshkrim të kontratës	17.1. Më së largu 2 ditë nga nënshkrimi i kontratës, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit publikon njoftimin për nënshkrim të kontratës përmes sistemit elektronik të prokurimit publik të Kosovës.	1. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit	Brenda 2 ditëve pas nënshkrimit të kontratës	1. Njoftimi për nënshkrim të kontratës	1. Analogjia sipas Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042  2. Rregulles për prokurim të Shërbimeve të Veçanta (konsulentet/kontraktoret individual) dhe Rregulles dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik  3. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
18.	Dërgimi i kontratës dhe anekseve tek njësi e kërkesës	18.1. Zyrtari përgjegjës i dërgon një ekzemplar të kontratës tek njësi e kërkuese, ZKF dhe menaxheri i kontratës.	1. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit	Nuk ka	1. Kontrata e nënshkruar	1. Analogjia sipas Ligji për Prokurimin Publik 04/L-042  2. Rregulles për prokurim të Shërbimeve të Veçanta (konsulentet/kontraktoret individual) dhe Rregulles dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik  3. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin

						Publik – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
<b>Fundi i procesit të angazimit të stafit përmes kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta</b>						

### 3. PROCESI I KONTRATAVE PËR SHËRBIME ME MARRËVESHJE TË VEÇANTA: LISTA E RREZIQEVE

3.1 Definimi jo i mirë dhe i qartë i specifikacioneve teknike/termave të referencës

3.2 Aplikimet e pranuar nuk janë cilësore dhe nuk i plotësojnë nevojat

3.3 Angazhimi i stafit jo më meritator (sipas kualifikimit, përvojës etj.)

3.4 Vonesa në shqyrtim të ankesave nga OSHP

	Numri i Referencës	3.1
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Operative
	Nën procesi	N/A
	Objektivi	Sigurimi i angazhimit të stafit profesional që ofron shërbime cilësore dhe në afatin kohor të paraparë për kontratë për shërbime të veçanta, duke ndjekur procedurat objektive, konkurruese dhe transparente të prokurimit dhe duke zbatuar ligjet, rregulloret dhe procedurat e prokurimit në fuqi
	Ngjarja e rrezikut	<b>Definimi jo i mirë dhe i qartë i specifikacioneve teknike/termave të referencës</b>
	Shkaku i Rrezikut	Bashkëpunim i dobët me njësinë kërkuese Planifikim i dobët
	Ndikimi/Pasoja	Më pak alternativa/aplikime Angazhimi i stafit jo më të përshtatshëm të mundshëm – që rrjedhimisht ndikon që edhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara Rritja e kostos
	Masat ekzistuese të kontrollit	Caktimi i stafit kompetent në hartimin e specifikave



ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	3
	Pasoja (1-5)	3
	Rezultati	9
	Prioriteti i rrezikut	Mesëm
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Të pa mjaftueshme
	Veprimi	Trajtimi dhe zvogëlimi
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Përcaktimi i specifikave sipas rezultateve të kërkuara. Përdor kërkesat funksionale dhe të performancës
	Forma e masave	Hartimi i specifikave efektive
	Burimet që kërkohen	Burime njerëzore dhe financiare
	Pronari i rrezikut	Njësia e kërkesës, Menaxheri i Prokurimit
	Data e përfundimit	I vazhdueshëm
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	KRPP, AQP, OSHP
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët

IDENTI FIKIMI I RREZIKUT	Numri i Referencës	3.2
	Kategoria	Operative, Strategjike
	Nën procesi	N/A

	Objektivi	Sigurimi i angazhimit të stafit profesional që ofron shërbime cilësore dhe në afatin kohor të paraparë për kontratë për shërbime të veçanta, duke ndjekur procedurat objektive, konkurruese dhe transparente të prokurimit dhe duke zbatuar ligjet, rregulloret dhe procedurat e prokurimit në fuqi
	Ngjarja e rrezikut	<b>Aplikimet e pranura nuk janë cilësore dhe nuk i plotësojnë nevojat</b>
	Shkaku i Rrezikut	Specifika teknike dhe terma të referencës të mangëta Vlera e parashikuar e prokurimit e ulët
	Ndikimi/Pasoja	Nevoja për përsëritjen e procesit Kosto shtesë Vonesa në proces
	Masat ekzistuese të kontrollit	Vlerësimi i kujdesshëm i ofertave, refuzimi i ofertave të pa përgjegjshme, anulimi dhe rishpallja e procesit
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	3
	Pasoja (1-5)	3
	Rezultati	9
	Prioriteti i rrezikut	Mesëm
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Të pa mjaftueshme
	Veprimi	Trajtimi dhe zvogëlimi
MENAXHIMI / MASAT PËR	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Hulumtimi i çmimeve të tregut Përdorimi i specifikave funksionale dhe të performancës
	Forma e masave	Hulumtim i tregut

	Burimet që kërkohen	Burime njerëzore dhe financiare
	Pronari i rrezikut	Njësia e kërkesës, Menaxheri i Prokurimit
	Data e përfundimit	I vazhdueshëm
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	KRPP, AQP, OSHP
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët

	Numri i Referencës	3.3
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	Operative, Financiare
	Nën procesi	N/A
	Objektivi	Sigurimi i angazhimit të stafit profesional që ofron shërbime cilësore dhe në afatin kohor të paraparë për kontratë për shërbime të veçanta, duke ndjekur procedurat objektive, konkurruese dhe transparente të prokurimit dhe duke zbatuar ligjet, rregulloret dhe procedurat e prokurimit në fuqi
	Ngjarja e rrezikut	<b>Angazhimi i stafit jo më meritor (sipas kualifikimit, përvojës etj.)</b>
	Shkaku i Rrezikut	Vlerësimi jo adekuat i aplikimeve Staf jo adekuat i angazhuar në vlerësimin e aplikimeve Specifikat teknike dhe termat e references të mangëta Vlera e parashikuar e prokurimit e ulët
	Ndikimi/Pasoja	Mos kryerja e shërbimeve apo shërbime të cilësisë së dobët Dështimi në zbatimin e kontratës


	Masat ekzistuese të kontrollit	Caktimi i stafit kompetent në komision të vlerësimit, mbikëqyrja e procesit nga menaxheri i prokurimit, përfshirja në komision vlerësues të stafit nga njësia e kërkesës
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	4
	Pasoja (1-5)	4
	Rezultati	16
	Prioriteti i rrezikut	Lartë
Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Të pa mjaftueshme
	Veprimi	Trajtim dhe zvogëlim
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Përmirësimi i procedurave të vlerësimit dhe i kritereve të vlerësimit si dhe refuzimi i ofertave të papranueshme si dhe vlerësimi i profilit të konsulentit/kontraktorit individual para nënshkrimit të kontratës  Proces i vlerësimit dhe përzgjedhjes sa më gjithëpërfshirës  Forcimi i teknikave të vlerësimit  Trajnimi i stafit
	Forma e masave	Plani i veprimit për implementim të përmirësimeve në proces të marrëveshjeve për shërbime të veqanta
	Burimet që kërkohen	Burime njerëzore dhe financiare
	Pronari i rrezikut	Njësia e kërkesës, Menaxheri i Prokurimit
	Data e përfundimit	I vazhdueshëm
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	KRPP, AQP, OSHP


	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët
--	---------------------------------------	--------

	Numri i Referencës	3.4
IDENTIFIKIMI I RREZIKUT	Kategoria	I jashtëm
	Nën procesi	N/A
	Objektivi	Sigurimi i angazhimit të stafit profesional që ofron shërbime cilësore dhe në afatin kohor të paraparë për kontratë për shërbime të veçanta, duke ndjekur procedurat objektive, konkurruese dhe transparente të prokurimit dhe duke zbatuar ligjet, rregulloret dhe procedurat e prokurimit në fuqi
	Ngjarja e rrezikut	<b>Vonesa në shqyrtim të ankesave nga OSHP</b>
	Shkaku i Rrezikut	Pa rregullsi gjatë procesit të prokurimit Numër i madh i ankesave në OSHP
	Ndikimi/Pasoja	Vonesa në përfundimin e procesit të prokurimit si dhe në ofrimin e shërbimeve të planifikuara. Mbetje e buxhetit të pashpenzuar
	Masat ekzistuese të kontrollit	Specifika teknike me kritere të qarta, objektive dhe të matshme të vlerësimit Vlerësimi i ofertave në bazë të kritereve të shpallura në dosjen e tenderit
ANALIZA E RREZIKUT	Mundësia (1-5)	3
	Pasoja (1-5)	4
	Rezultati	12
	Prioriteti i rrezikut	Lartë


Vlerësimi	Përshtatshmëria e masave ekzistuese	Të pa mjaftueshme
	Veprimi	Monitorim
MENAXHIMI/ MASAT PËR ZVOGLIMIN E RREZIKUT	Masat shtesë për trajtimin e rrezikut	Menaxhim i procesit të prokurimit me kujdes të shtuar, angazhimi i stafit profesional në proces si dhe mbikëqyrja e rregullt e procesit
	Forma e masave	Plani i menaxhimit të procesit të marrëveshjeve për shërbime të veqanta
	Burimet që kërkohen	Burime njerëzore dhe financiare
	Pronari i rrezikut	Njësia e kërkesës, Menaxheri i Prokurimit
	Data e përfundimit	I vazhdueshëm
	Ndërlidhje me struktura /Institucione tjera	KRPP, AQP, OSHP
	Statusi i rrezikut pas masës së marrë	I ulët

**1. PROCESI I KONTRATAVE PËR SHËRBIME ME MARRËVESHJE TË VEÇANTA: DIAGRAMI I PROCESIT**









#### **IV. PROCESI I SHPENZIMEVE - MALLRA DHE SHËRBIME**

## 2. PROCESI I SHPENZIMEVE - MALLRA DHE SHËRBIME: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

<b>Titulli i procesit:</b>	Procesi i Shpenzimeve Publike për Mallra dhe Shërbime
<b>Organizata Buxhetore:</b>	Komuna Lipjan
<b>Data e rishikimit:</b>	<DATA>
<b>Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:</b>	<p>Procesi ka për qëllim përshkrimin e procedurave të procesimit të shpenzimeve publike për kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime. Procesi synon që të sigurojë zbatimin e rregulloreve financiare dhe të sigurojë përputhjen me kërkesat e raportimit financiar sipas rregulloreve në fuqi. Ky proces gjithashtu shënon hallkat vendimmarrëse për proceset e prokurimit publik në rast të shpenzimeve të cilat parashihen të ekzekutohen nëpërmjet procedurave formale të prokurimit publik.</p> <p>Procesi evidenton hallkat vendimmarrëse dhe teknike brenda Komunës sa i përket proceseve të ekzekutimit të pagesave dhe regjistrimit në sistemet financiare të TI. Procesi gjithashtu evidenton proceset e komunikimit dhe bashkërendimit me Thesarin e Ministrisë së Financave për ekzekutimin e pagesave.</p>
<b>Përgjegjësi për rishikim të procesit:</b>	Njësia Qendrore Harmonizuese – Ministria e Financave
<b>Versioni:</b>	V. 01/2018
